



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE TE BRËNDSHME
SHËRBIMI PËR ÇËSHTJET E BRËNDSHME DHE ANKESAT

Nr. 138 Prot

Kopje 1;
Tiranë më 27/07/2020.

URDHËR

Nr. 61, datë, 27.07.2020

PËR

MIRATIMIN E RREGULLORES “PROCEDURAT PËR HEDHJEN E SHORTIT”

Në mbështetje të gërmës “a” të nenit 3, nenit 12 të ligjit nr.70/2014, “Për Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Punëve të Brendshme”, nenit 7 të Rregullores së Shërbimit të miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.829, datë 03.12.2014, si dhe ligjit nr.12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.


URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores “Procedurat për hedhjen e shortit”.
2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Vlerësimit Kalimtar dhe Periodik, në Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Brendshme.
3. Për kontrollin e zbatimit të këtij Urdhri ngarkohet Zëvendës drejtori i Përgjithshëm i SHÇBA-së dhe Drejtori i Drejtorisë së Vlerësimit Kalimtar dhe Periodik.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Muhamet RRUMBULLAKU



RREGULLORE

PËR

PROCEDURAT PËR HEDHJEN E SHORTIT

*Miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit për Çështjet e
Brendshme dhe Ankesat*

Nr. 61 datë 27.07.2020

TABELA E PËRMBAJTJES

Kreu i parë	Dispozita të përgjithshme
Neni 1	Qëllimi
Neni 2	Objekti
Neni 3	Parimet e ushtrimit të funksioneve dhe organizimit të veprim institucionale
Neni 4	Përkufizime
Neni 5	Rregulla të përgjithshme
Neni 6	Procedurat e shortit për ndarjen e trupave vlerësuese
Neni 7	Procedurat e shortit për caktimin e anëtarit zëvendësues
Neni 8	Kompetencat e anëtarëve të trupave të vlerësimit

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave, procedurave dhe standardeve që do të zbatohen për për zgjedhjen nëpërmjet shortit të anëtarëve të trupës vlerësuese.

Neni 2 Objekti

1. Objekt i kësaj rregulloreje është përcaktimi i:
a) procedurave të shortit për ndarjen e trupave vlerësuese;
b) procedurave të shortit për caktimin e anëtarit zëvendësues;
c) procedurat e shortit për shpërndarjen e çështjeve në trupat vlerësuese si dhe caktimin e anëtarit relator.

Neni 3 Parimet e ushtrimit të funksioneve dhe organizimit të veprimtarisë institucionale

Rregullat dhe procedurat e hedhjes së shortit bazohen në parimin e transparencës, barazisë, efikasitetit, efikasitetit dhe objektivitetit, si dhe garanton ndarje të barabartë çështjesh midis anëtarëve të trupave të vlerësimit.

Neni 4 Përkufizime

Në këtë rregullore termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Punonjës i SHÇBA-së" është personi i emëruar në Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, sipas legjislacionit në fuqi, me përjashtim të nëpunësve civilë.
2. "Punonjës policie" është personi i emëruar në Policinë e Shtetit, me gradë policore, në përputhje me ligjin për Policinë e Shtetit.
3. "Punonjës i Gardës së Republikës" është personi i emëruar në Gardën e Republikës, me gradë, në përputhje me ligjin për Gardën e Republikës së Shqipërisë.
4. "Subjekt vlerësimi" janë punonjësit, sipas përcaktimeve të bëra në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni, si dhe ish-punonjësit, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 6, pika 5, të ligjit nr.12/2018.
5. "Grup vlerësimi" është njësia e vlerësimit e organizuar në formën e organit kolegjal përgjegjës për shqyrtimin, verifikimin dhe marrjen e vendimeve ndaj punonjësve që do të vlerësohen sipas ligjit nr.12/2018 i ndryshuar.
6. "Procesi i vlerësimit" përfshin si procesin kalimtar, ashtu dhe procesin periodik të vlerësimit të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave në Ministrinë e Brendshme.

7. "Partnerë ndërkombëtarë" janë organizatat ndërkombëtare dhe misionet e huaja që asistojnë Ministrinë e Brendshme, me të cilat organet e vlerësimit konsultohen gjatë përzgjedhjes së anëtarëve të organeve të vlerësimit dhe vlerësimit kalimtar të punonjësve.

8. "Short" është një mënyrë për të ndarë me paanësi në mënyrë rastësore anëtarët e trupës së vlerësimit, për secilin subjekt vlerësimi.

Neni 5

Rregulla të përgjithshme

1. Procedurat e hedhjes së shortit, realizohen në prani të anëtarëve të trupave të vlerësimit.

2. Drejtuesi i Trupave të Vlerësimit me autorizim të Drejtorit të Përgjithshëm drejton procedurën e shortit me ndihmën e një anëtari të trupës vlerësuese.

3. Për çdo rast të organizimit të shortit, drejtuesi i Trupave të Vlerësimit, njofton me shkrim ose me e-mail të gjithë anëtarët, jo më vonë se dy ditë pune përpara datës së hedhjes së shortit. Njoftimi përmban datën, orën dhe sallën e zhvillimit të shortit.

4. Procedurat për hedhjen e shortit zhvillohen në mjediset e punës ku zhvillon veprimtarinë trupa e vlerësimit.

5. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, procedurat e shortit do të mbahen në datat e përcaktuara nga titullari i institucionit.

6. Përveç shortit të organizuar SHÇBA organizon short të veçantë dhe të posaçëm brenda 30 ditëve nga marrja dijeni zyrtarisht për punonjës të veçantë që për shkak të emërimit në një funksion të caktuar, do të vlerësohen me përparësi për subjektet e vlerësimit, të cilët kanë përparësi për shkak të statusit si kandidatë për tu emëruar në struktura drejtuese ose me risk të lartë korrupsioni.

7. Lista nominale e subjekteve të vlerësimit, si dhe data e shortit të veçantë e të posaçëm, sipas pikës 6 të këtij neni, përcaktohet paraprakisht me vendimin të Drejtorit të Përgjithshëm, të paktën 3 (tre) ditë përpara datës së hedhjes së shortit.

8. Kërkesat për dorëheqje të paraqitura nga subjektet e vlerësimit, të cilët nuk janë shortuar, si dhe përfundimi i procedurave të vlerësimit për subjektet që kanë mbushur moshën për pension përpara se të bëhen pjesë e procedurave të shortimit, shqyrtohen nga një trup vlerësuese e zgjedhur me short për një periudhë njëvjeçare.

9. Të gjitha procedurat e shortit, për çdo rast, evidentohen në procesverbalin që mbahet për këtë qëllim nga një anëtar i trupave vlerësuese dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët.

Neni 6

Procedurat e shortit për ndarjen e trupave vlerësuese

1. Çdo trupë vlerësuese përbëhet nga relatori dhe dy anëtarë. Kryesuesi zgjidhet midis dy anëtarëve me dakordësi në mbledhjen e parë të trupës vlerësuese. Në rast se nuk arrihet mirëkuptimi, kryesuesi zgjidhet me short nga anëtarët e trupës.

2. Përpara fillimit të procedurave të shortit, emrat e të gjithë anëtarëve të trupave të vlerësimit shkruhen në shirita të barabartë letre, me gërmë *arial 12*, verifikohen për saktësinë nga të gjithë të pranishmit në sallë nëpërmjet ekspozimit të emrave nga drejtuesi i trupave të vlerësimit i cili, pas verifikimit, i palos në mënyrë të njëjtë dhe i vendos në goglat përkatëse.

3. Goglat, përpara se të hidhen në kutinë transparente, preken me dorë të paktën nga tre

anëtarë, përveç Drejtuesit, për të verifikuar njëtrajtshmërinë dhe barazinë e tyre në formë dhe temperaturë. Pas këtij verifikimi, Drejtuesi i vendos goglat në kutinë transparente dhe i përziën, me qëllim sigurimin e barazisë në përzgjedhje.

4. Drejtuesi i trupave të vlerësimit, me cilësinë e drejtuesit të shortit, përzgjedh në mënyrë rastësore tri gogla nga kutia transparente. Pasi i hap goglat një e nga një, lexon me zë të lartë emrat e tre anëtarëve, të cilët përbëjnë trupën e parë vlerësuese.

5. E njëjta procedurë, me të njëjtën radhë veprimesh, kryhet edhe për përcaktimin e trupave të tjera vlerësuese.

6. Në përfundim të kësaj faze të hedhjes së shortit, drejtuesi lexon edhe një herë me zë të lartë emrat e anëtarëve të çdo trupe vlerësuese.

Neni 7

Procedurat e shortit për caktimin e anëtarit zëvendësues

1. Anëtari zëvendësues përcaktohet me short për çdo trupë vlerësuese duke filluar nga trupa e parë vlerësuese e përzgjedhur, sipas nenit 6 të kësaj rregulloreje.

2. Procedura e shortit për caktimin e anëtarit zëvendësues zhvillohet njësoj si procedura për përzgjedhjen e anëtarëve të trupës vlerësuese.

3. Në përfundim të të gjithë kësaj procedure, Drejtuesi i trupave vlerësuese lexon me zë të lartë edhe një herë emrat e anëtarëve zëvendësues për çdo trup gjykues.

Neni 8

Procedurat e shortit për shpërndarjen e çështjeve të anëtarit relator

1. Shpërndarja e barabartë dhe rastësore e çështjeve në trupa vlerësuese sigurohet nëpërmjet caktimit me short të anëtarit relator.

2. Të gjithë anëtarët do të jenë anëtarë relatorë në numër të barabartë çështjesh.

3. Ndarja e çështjeve sipas anëtarit relator, në shortet që do të zhvillohen sipas pikës 6 të nenit 5 të kësaj rregulloreje.

4. Ndarja e çështjeve sipas anëtarit relator, në shortet që do të zhvillohen sipas pikës 7 dhe 8 të nenit 5 të kësaj rregulloreje, do të përcaktohet me vendim, sipas pikës 9 të nenit 5 të kësaj rregulloreje.

5. Drejtuesi i trupave vlerësuese, pasi lexon emrat e subjekteve, të shkruar në shirita të barabartë letre, me gërme *arial 12*, me ndihmën e një anëtari, palos shiritat në mënyrë të njëjtë dhe i vendos në goglat përkatëse. Goglat, përpara se të hidhen në kuti, preken me dorë të paktën nga tre anëtarë për të verifikuar njëtrajtshmërinë dhe barazinë e tyre në formë dhe temperaturë. Më tej ato do të vendosen në kuti transparente.

6. Të paktën, tre anëtarë do të jenë të pranishëm gjatë përgatitjes së goglave. Pas procedurës së verifikimit, goglat vendosen në kutinë transparente dhe përzihen, në mënyrë që të garantohet barazia në përzgjedhje.

7. Çdo anëtar i trupës së vlerësimit, sipas rendit alfabetik, përzgjedh goglën përkatëse, derisa të plotësohet numri i subjekteve të përcaktuara për çdo anëtar/relator.

8. Në rast të një procedure të veçantë dhe të posaçme, goglat vendosen në një kuti të vetme transparente. Përzgjedhja kryhet me radhë nga anëtarët e trupave vlerësuese në rend afalbetik, deri në përfundim të listës së subjekteve të vlerësimit të miratuar me vendimin përkatës të titullarit të institucionit.

9. Në çdo short të organizuar, Drejtuesi i trupave të vlerësimit lexon me zë të lartë emrin e subjektit të vlerësimit që gjendet në gogël. Ky emër, pasi regjistrohet në procesverbal, korrespondohet me emrin përkatës të relatorit të çështjes.

10. Në mungesë të ndonjë anëtari të trupës së vlerësimit, tërheqja e goglave, në emër të tij, do të bëhet nga drejtuesi i trupave të vlerësimit.

11. Në rast zëvendësimi të relatorit, anëtarit zëvendësues të cilit i caktohet çështja, do të tërheqë më pak çështje në cilësinë e relatorit në shortin e radhës. Anëtarit relator të zëvendësuar, në shortin e radhës do t'i caktohen çështjet përkatëse në vend të anëtarit zëvendësues, për aq çështje sa është zëvendësuar. Ky rregull zbatohet për çdo zëvendësim të relatorit të çështjes.

12. Në përfundim të kësaj procedure, pasi janë hapur të gjithë goglat, drejtuesi i trupave lexon edhe një herë me zë të lartë emrat e subjekteve të vlerësimit të shortuar dhe relatorëve përkatës. Goglat dhe shiritat e letrave të përdorur në këtë fazë të shortit, administrohen, duke u përjashtuar nga shortimi i mëtejshëm.

13. E gjithë procedura sipas këtij neni, pasqyrohet në procesverbal, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e pranishëm gjatë hedhjes së shortit.

14. Pas përfundimit të çdo shorti, secili prej subjekteve të vlerësimit identifikohet me numër rendor në regjistrin e dosjeve që administrohet nga personi i autorizuar.